

**I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 1 (një) vende pune për personel ndihmësakademik (Specialist Rrjeti) në Institutin e Gjeoshkencave pranë Departamentit të Sizmologjisë:**

**A. Kandidatët për personel ndihmësakademik pranë Departamentit të Sizmologjisë në Institutin e Gjeoshkencave, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:**

1. Të kenë diplomë të ciklit të dytë të studimeve në fushat: Inxhinieri Telekomunikacioni, Inxhinieri Elektronike, Inxhinieri Informatike, Teknologji Informacioni;
2. Të kenë njohuri të mira në sistemet LINUX, windows etj;
3. Të kenë njohuri në programim;
4. Të kenë njohuri të gjuhëve të huaja, preferohet gjuhë Angleze e dokumentuar;
5. Të kenë leje drejtimi automjeti;
6. Të kenë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup;
7. Të jenë të disponueshëm të punojnë të pavarur në terren për riparimin e pajisjeve, si dhe në qendrën e monitorimit për kontrollin, mirëmbajtjen e pajisjeve të rrjetit sizmik, përfshirë këtu dhe situata emergjente sizmike;
8. Preferohen kandidatët me notë mesatare sa më të lartë;
9. Preferohen kandidatët me eksperiencë pune në fushat e mësipërme, së paku 5 vite.

**II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **01.02.2023** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.